

Në bazë të nenit 24, paragrafi (1), pika 1), nënpika 4 dhe nenit 25 paragrafi (3) të Ligjit të Energjetikës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 96/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/19), Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 4 korrik 2019, solli këtë

RREGULLORE

TË MËNYRËS DHE TË PROCEDURËS SË PËRCJELLJES SË FUNKSIONIMIT TË TREGJEVE TË ENERGJISË

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Qëllimet e rregullores

- Ø Me këtë rregullore të Mënyrës dhe të Procedurës së Përcjelljes së Funkcionimit të Tregjeve të Energjisë (në tekstin e mëtejshëm: Rregullore) përcaktohet mënyra dhe procedurat e përcjelljes së funksionimit të tregjeve të energjisë përmes përcjelljes së aktiviteteve të operatorëve të sistemeve të transmetimit dhe të shpërndarjes, që kanë lidhje me funksionimin e tregjeve të energjisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe aktiviteteve të të gjithë bartësve të tjerë të licencave të kryerjes së veprimtarive energjetike.
- Ø Përcjelljen e funksionimit të tregjeve të energjisë e kryen Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit i Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: KRRE).
- Ø Qëllimi i Përcjelljes së funksionimit të tregjeve të energjisë është sigurimi dhe/ose mundësimi:
 - 1) i ritjes së efikasitetit, konkurrencës dhe transparencës së tregjeve të energjisë,
 - 2) zbulimi i parregullsive, prishja e konkurrencës dhe konkurrenca jolojale e tregut,
 - 3) vlerësimi i plotësimit të detyrimeve për sigurimin e sigurisë në furnizim nga kryerësit e veprimtarive të rregulluara energjetike dhe
 - 4) zbulimi i aktiviteteve në tregjet e energjisë, që janë në kundërshtim me ligjet, rregullat dhe detyrimet e tjera të përcaktuara në licencat e kryerjes së veprimtarive energjetike.
- Ø Nëse gjatë Përcjelljes së gjendjeve dhe funksionimit të tregjeve të energjisë, KRRE-ja përcakton ndonjë parregullsi, ajo sjell vendim, me të cilin imponohet marrja e masave të detyrueshme përkatëse, përfshirë edhe ndalesën për sjelljen jokorrekte të kryerësit të veprimtarisë energjetike, me qëllim që të sigurohet siguria në furnizim, funksionimi efikas, konkurent dhe jodiskriminator në tregjet e energjisë si dhe mbrojtja e të drejtave të konsumatorëve të sistemeve energjetike. Në vendim theksohen masat, të cilat duhet të merren nga kryerësi i veprimtarisë energjetike si dhe afatet, në të cilat duhet të merren këto masa dhe detyrimi i dërgimit të raporteve për masat e marra.
- Ø Gjatë kryerjes së punëve nga paragrafi (4), KRRE-ja bashkëpunon me organe dhe institucione të tjera kompetente shtetërore, si dhe me Bordin Rregullator të Komunitetit Energjetik, trupat rregullatorë të energjetikës të paë[ve kontraktuese dhe pjesmarrësve në Komunitetin Energjetik dhe me Sekretariatit e Komunitetit Energjetik.

Neni 2

Definicionet

- Ø Definicionet e shprehjeve të veçanta që janë pjesë e Ligjit të Energjetikës, zbatohen edhe në këtë Rregullore.
- Ø Disa shprehje të përdorura në këtë rregullore, e kanë kuptimin në vijim:
 - 1) **kërkesë e informatave nga konsumatorët** - kërkesa e informatave apo këshillave nga konsumatori derit e trupi i veprimit sipas ankesave, apo deri te qendra e vetme informative e ofruesit të shërbimeve ose deri tek organizata, e cila iu jep informata konsumatorëve;

- 2) **bilanci i energjisë** - shqyrtimi i energjisë, e cila hyn në një sistem energjetik, energjia që del nga sistemi dhe humbjet e energjisë, nëse ekzistojnë;
- 3) **amvisëri konsumatore të energjisë elektrike** – amvisëritë konsumatore të energjisë elektrike, të grupuara sipas konsumit vjetor të energjisë elektrike (sipas klasifikimit të EUROSTAT-it) në 5 grupe;
- 4) **amvisëri konsumatore të të gazit natyror**- amvisëritë konsumatore të gazit natyror, të grupuara sipas konsumit vjetor të gazit natyror (sipas klasifikimit të EUROSTAT-it) në 3 grupe;
- 5) **konsumatorë industrial të energjisë elektrike** - konsumatorët e energjisë elektrike, që nuk bëjnë pjesë në kategorinë e amvisërive (konsumatorë industrial dhe komercial) dhe janë të grupuar në 7 grupe (sipas klasifikimit të EUROSTAT), varësisht nga konsumi i tyre vjetor i energjisë elektrike;
- 6) **konsumatorë industrial të gazit natyror** - konsumatorët e gazit natyror, që nuk bëjnë pjesë në kategorinë e amvisërive (konsumatorë industrial dhe komercial) dhe janë të grupuar në 6 grupe (sipas klasifikimit të EUROSTAT), varësisht nga konsumi i tyre vjetor i gazit natyror;
- 7) **konsumator i vogël** – konsumator i energjisë elektrike, respektivisht i gazit natyror është subjekt, numri mesatar i të punësuarve të të cilit gjatë dy viteve të fundit përlogartiëse është më i ulët se 50 punëtorë dhe ka të ardhura mesatare vjetore më të ulëta se dy milionë euro në kundërvlerë në denarë, me përjashtim të prodhuesit të energjisë elektrike dhe të operatorit të sistemit të transmetimit dhe të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, respektivisht të gazit natyror;
- 8) **bartës i licencës** - person, të cilit KRRE-ja i lëshon licencë të kryerjes së veprimtarisë energjetike në përputhje me Ligjin e Energjetikës;
- 9) **operatori i sistemit** - nënkupton operatorin e sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike apo operatorin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike kur bëhet fjalë për energjinë elektrike, operatorin e sistemit të transmetimit të gazit natyror apo operatorin e sistemit të shpërndarjes së gazit natyror kur bëhet fjalë për gazin natyror ose operatorin e sistemit të shpërndarjes së energjisë termike kur bëhet fjalë për energjinë termike;
- 10) **tregjet e energjisë** - tregu i energjisë elektrike, tregu i gazit natyror, tregu i naftës së papërpunuar, i derivateve të naftës dhe i lëndëve djegëse për transport dhe tregu i energjisë termike;
- 11) **tregu i energjisë me shumicë** - tregu i shitjes dhe blerjes së energjisë, që i përfshin transaksionet e realizuara mes prodhuesve, tregtarëve, furnizuesve dhe konsumatorëve, të cilët në mënyrë të pavarur marrin pjesë në treg;
- 12) **tregu i energjisë me pakicë** - tregu i shitjes së energjisë për konsumatorët, që i përfshin transaksionet mes furnizuesve dhe konsumatorëve;
- 13) **periudha e njoftimit** - periudhë kohore, të cilës i referohen të dhënat dhe informatat, që i dërgojnë bartësit e licencave;
- 14) **konsumator-prodhues** - e ka domethënien e përcaktuar me Rregulloren e Burimeve të Rinovueshme të Energjisë, të miratuar në bazë të Ligjit të Energjetikës;
- 15) **ankesë e konsumatorëve** - shprehje (përmes formave të ndryshme të mundshme: letër, postë elektronike, thirrje telefonike, kërkesa fizike) të pakënaqësive të konsumatorëve;
- 16) **furnizimi me energji** - shitje e energjisë të konsumatorët, ndërsa mund të përfshijë edhe tregtinë me energji;
- 17) **furnizues me energji** - bartës i licencës, i cili i furnizon konsumatorët me energji dhe mund të kryejë tregtinë me energji;
- 18) **furnizuesi në rastin e fundëm** - furnizuesi me energji elektrike apo me gaz natyror, që ka për detyrim të sigurojë shërbimin publik në rastin e fundëm me energji elektrike apo me gaz natyror, nën kushtet e parapara me Ligjin e Energjetikës;
- 19) **furnizues me gaz natyror me detyrim për shërbimin publik** - furnizues me gaz natyror për amvisëritë dhe konsumatorët e vegjël me detyrim për shërbimin publik, i zgjedhur me procedurë tenderi të zbatuar sipas Ligjit të Energjetikës;

20) **tregtar ose furnizues i huaj** – filiali i personit të huaj, i cili është i regjistruar në Regjistrin e Tregtarëve dhe Furnizuesve të Huaj me Energji Elektrike dhe me Gaz Natyror, që e udhëheq KRRE-ja;

21) **tregtia me energji** - blerja e energjisë për shitje të mëtuftjeshme në tregjet e energjisë me shumicë;

22) **furnizuesi universal** - bartës i licencës së furnizimit me energji elektrike në bazë të detyrimit për sigurimin e shërbimit universal, furnizim i amvisërive dhe i konsumatorëve të vegjël, i zgjedhur në bazë të Ligjit të Energjetikës.

Ø Lista e shkurtesave, të cilat përdoren në këtë rregullore:

- SEE – Sistemi Enelektroenergjetik,
- OSSH – Operatori(ët) e sistemit(eve) të shpërndarjes, përfshirë edhe operatorët e sistemeve të mbyllura të shpërndarjes,
- OSTEE – Operatori i Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike,
- BRE – Burimet e Rinovueshme të Energjisë,
- OTEE – Operatori i Tregut të Energjisë Elektrike,
- OTOEE – Operatori i Tregut Organizuar të Energjisë Elektrike,
- OSSH – Operatori(ët) e sistemit(eve) të shpërndarjes së gazit natyror, përfshirë edhe operatorët e sistemeve të mbyllura të shpërndarjes,
- OST – Operatori i Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror,
- OTGN – Operatori i Tregut të Gazit Natyror
- KRRE – Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit i Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- SAIDI – indikator i kohëzgjatjes mesatare të ndërprerjeve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike,
- SAIFI – indikator i kohëzgjatjes mesatare të ndërprerjeve për konsumator në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike,
- EUROSTAT – Zyrja e statistikave të UE-së.

Neni 3

Zbatimi i rregullores

- (1) Përcjellja e funksionimit të tregjeve të energjisë nënkupton përmbledhjen e aktiviteteve, të cilat i referohen mbledhjes, përpunimit dhe analizës së të dhënave dhe informatave, si dhe publikimit të informatave për:
- 1) plotësimin e detyrimeve të përcaktuara ligjore të kryerësve të veprimtarive të rregulluara energjetike, të cilat i referohen mundësit të sigurosë në furnizimin me energji elektrike, gaz natyror dhe energji termike,
 - 2) funksionimi i tregjeve të energjisë me qëllim të sigurimit të avancimit të tyre dhe sigurisë së furnizimit me energji,
 - 3) zbatim i rregullave të ndarjes së kapaciteteve përtejkuftare të transmetimit dhe për menaxhimin me ngulfatjet në sistemet e transmetimit të energjisë elektrike dhe të gazit natyror, përfshirë edhe përçuesit interkontaktues, në përputhje me detyrimet në Republikën e Maqedonisë së Veriut të marra me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara,
 - 4) zbatim i rregullave të organizimit të balancimit të sistemit elektroenergjetik dhe rregullave të organizimit të balancimit të sistemit të gazit natyror, si dhe sigurimin e shërbimeve të balancimit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, si dhe sigurimin e shërbimeve të balancimit të energjisë elektrike dhe gazit natyror,
 - 5) realizimi i planeve të përgatitura nga operatorët e sistemeve të transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë, të cilët i referohen uljes së humbjeve në sistemin përkatës energjetik dhe sipas nevojës revizion i këtyre planeve,

- 6) qasja deri te rjetet për impjantet e reja prodhuese të prodhimit të energjisë elektrike, posaçërisht largimi i pengesave, të cilat do të mund të pengojnë qasjen e pjesmarrësve të rinj në tregun e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme të energjisë,
- 7) sasi të prioritare të dërguara të energjisë elektrike dhe për kufizimet e qasjes prioritare të rjetit dhe/ose dërgesës prioritare,
- 8) kushtet e qasjes deri te kapacitetet e depozitimit në sistemin e gazit natyror dhe shërbimet e tjera sistemore të gazit natyror,
- 9) përdorimi i të hyrave të realizuara nga menaxhimi me ngulfatjen në sistemet e transmetimit të energjisë elektrike dhe të gazit natyror,
- 10) përdorimi i të hyrave nga komprsimet e qasjes dhe kyçjes në rjetet e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë dhe investimi i tyre në mirëmbajtje të rrjeteve,
- 11) koha që iu nevojitet operatorëve të sistemeve të transmetimit dhe të shpërndarjes për kyçje të konsumatorëve të rinj dhe për largimin e defekteve,
- 12) harmonizimi në punën e operatorëve të sistemeve të transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe gazit natyror me rregullat e sigurisë dhe konfidencialitetit të sistemeve,
- 13) publikimi me kohë i të gjitha informatave relevante nga operatorët e sistemeve të transmetimit dhe të shpërndarjes në përputhje me detyrimet dhe standardet ndërkombëtare të pranuar, në lidhje me konsumin, prodhimin, depozitimin dhe humbjet e energjisë, menaxhimi me sistemet dhe interkoneksionet, përdorimi i rjetit dhe shpërndarja e kapaciteteve të palëve të interesuara, balancimi i kërkesës, sasi të vlerësuara dhe të planifikuara të energjisë dhe ndryshimet në strukturën e kapaciteteve të prodhimit, depozitimit dhe transmetimit të energjisë,
- 14) niveli i transparencës së çmimeve të energjisë elektrike dhe gazit natyror në tregjet përkatëse,
- 15) vëllimi financiar dhe real i transaksioneve të planifikuara dhe të realizuara nga operatorët e sistemeve të transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë si dhe të tregtarëve dhe të furnizuesve me energji,
- 16) ndryshimet në strukturën e pronësisë të kryerësve të veprimtative energjetike, posaçërisht të operatorëve të sistemeve të transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë,
- 17) zbatimi i sistemeve tarifore dhe të tarifave të caktuara,
- 18) zbatimi i kushteve dhe i kompensimeve të kyçjes së impjanteve të reja prodhuese në rjet,
- 19) puna e bartësve të licencave sa i përket detyrimeve të tyre të përcaktuara në licencat e lëshuara, përfshirë edhe punët në lidhje me transmetimin përtejkuftar të energjisë elektrike dhe gazit natyror,
- 20) paraqitja e detyrimeve kufizuese të marrëveshjeve, përfshirë edhe dispozitat e ekskluzivitetit, me të cilat mund të pamundësohen konsumatorët, që të lidhin marrëveshje njëkohësisht me më shumë furnizues me energji, ose të cilët mund t'ua kufizojnë të drejtën e zgjedhjes së furnizuesit,
- 21) zbatimi i masave të mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve nga operatorët e sistemeve të transmetimit dhe të shpërndarjes, si dhe furnizuesit, posaçërisht sa i përket marrjes së informatave të plota dhe të kuptueshme në lidhje me çmimet dhe tarifën, që janë të zbatueshme për amvisëritë, përfshirë edhe mënyrat e pagesës së llogarive të energjisë së shpenzuar, shkyçjet e përdoruesve nga sistemet, kompensimet e kyçjeve në rjet, veprimet sipas kundërshtimeve dhe parashtrësive të dërguara nga konsumatorët, të drejtat e konsumatorëve të marrin të dhëna për konsumin personal dhe sigurimi i informatave për konsumatorët që i referohen të drejtave të tyre,
- 22) realizimi i fitimeve për konsumatorët, të cilët dalin nga funksionimi efikas i tregjeve të energjisë, stimulimi i konkurrencës efikase dhe nga masat e marra për mbrojtjen e konsumatorëve,
- 23) cilësia e shërbimeve, të cilat i japin kryerësit e veprimtarive energjetike, përfshirë edhe mënyrën, në të cilën veprohet me kundërshtimet nga konsumatorët,

- 24) zbatimi i detyrimeve për kryerjen e kontabilitetit të veçantë për personat, të cilët kryejnë një ose më shumë veprimtari të rregulluara energjetike ose një apo më shumë veprimtari të rregulluara energjetike dhe veprimtari tjetër energjetike apo tjetër veprimtari, si dhe ndarja efikase e evidencës kontabiliste në përputhje me Ligjin e Energjetikës,
- 25) zbatimi i programeve për harmonizimin e operatorëve të sistemeve përkatëse energjetike, me qëllim që të sigurohet jodiskriminimi, transpareca dhe paanshmëria në funksionimin e tregjeve të energjisë,
- 26) rregullsia në publikimin e të dhënave për gjendjet në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike dhe dërgimi i tyre deri te trupat përkatës ndërkombëtar,
- 27) investimet në kapacitetet prodhuese të energjisë elektrike sa i përket sigurisë në furnizimin me energji,
- 28) zbatimi i masave mbrojtëse në rastet e gjendjes së krizës dhe masat e përcaktuara në Programin e Mbrojtjes së Konsumatorëve të Ndjeshëm,
- 29) bashkëpunimi teknik mes operatorëve të sistemeve të transmetimit, operatorëve të tregjeve të energjisë elektrike dhe gazit natyror me operatorët përkatës nga palët e interesuara dhe pjesmarrësit në Marrëveshjen për Komunitetin Energjetik.

Neni 4

Mënyra e zbatimit

- (1) Bartësit e licencave janë të detyruar të dërgojnë deri te KRRE-ja, të dhëna dhe informata të përcaktuara në këtë rregullore, të nevojshme për Përcjelljen e funksionimit të tregjeve të energjisë në mënyrë, formë dhe sipas kushteve të përcaktuara nga KRRE.
- (2) Në përjashtim të paragrafit (1), të dhëna për prodhimin mujor të energjisë elektrike, nuk dërgojnë bartësit e licencave të prodhimit të energjisë elektrike, të cilëve iu është miratuar përdorimi i tarifave preferenciale.
- (3) KRRE-ja i përcakton dhe i publikon në faqen e saj të internetit, formularët e llojit, në të cilët dërgohen informatat dhe të dhënat nga paragrafi (1) si dhe instrukcionet e mënyrës së marrjes së formularëve, mënyra e vendosjes së të dhënave dhe informatat në formularët dhe dërgimi i formularëve.
- (4) KRRE-ja e publikon ndryshimin e formularëve dhe instrukcionet për mënyrën e dërgimit të të dhënave dhe informatave në formularët e ndryshuar në faqen e saj të internetit më së voni deri më 90 ditë para afatit përfundimtar për dërgimin e të dhënave, që i referohen tregut të energjisë elektrike, respektivisht 60 ditë para skadimit të afatit për dërgimin e të dhënave për tregjet e tjera të energjisë.
- (5) Formularët e llojit nga paragrafi (3) dërgohen ekskluzivisht në formë elektronike përmes web platformës së posaçme, të cilën e formon dhe e mirëmban KRRE-ja.
- (6) Të dhënat dhe informatat nga paragrafi (1), sipas rregullit, dërgohen më së voni 30 ditë nga dita e fundit kalendarike të periudhës së njoftimit, përveç të dhënave që i referohen tregut të energjisë elektrike, për të cilat afati është 60 ditë, nëse në formularët e llojit nga paragrafi (3) nuk janë përcaktuar afate të ndryshme për dërgim.
- (7) Periudha e njoftimit, të cilës i referohen formularët e llojit nga paragrafi (3), me rregull, është një muaj kalendarik, vetëm nëse nuk është përcaktuar ndryshe me këtë rregullore apo në formularët e llojit nga paragrafi (3).
- (8) Periudha e njoftimit për numrin e konsumatorëve, sasive dhe çmimeve mesatare të energjisë së shitur, si dhe të tarifave të transmetimit dhe të shpërndarjes sipas grupit të konsumatorëve sipas klasifikimit të EUROSTAT është gjashtë muaj.
- (9) Përveç të dhënave që dërgohen deri te KRRE-ja përmes formularëve të llojit nga paragrafi (3), KRRE-ja mund të kërkojë nga bartësit e licencave të dërgojnë edhe të dhëna të tjera dhe informata të caktuara në licencë, edhe atë:
 - 1) raporte vjetore në formë elektronike përmes web platformës nga paragrafi (5) dhe
 - 2) sipas nevojës, të dhëna dhe informata në formë elektronike apo të shtypur, që janë të domsdoshme për realizimin e aktiviteteve nga neni 3.
- (10) Në sensin e kësaj rregullore, gjatë përcaktimit të detyrimeve për dërgimin e të dhënave:

- 1) bartësit e licencave të veprimtarive energjetike, të cilëve iu është përcaktuar detyrimi i sigurimit të shërbimit publik, duhet të dërgojnë të dhëna në formularë të veçantë të përcaktuar për secilën veprimtari energjetike dhe/ose shërbim publik, ndaras dhe
 - 2) tregtarët e huaj apo furnizuesit do të llogaritet se janë bartës të licencës përkatësisht nga lloji i veprimtarisë, me të cilën janë të regjistruar në Regjistrin e Tregtarëve të Huaj dhe të Furnizuesve me Energji Elektrike apo me Gaz Natyror dhe duhet të dërgojnë të dhëna sipas kësaj rregulloreje.
- (11) Personat, të cilët njëkohësisht posedojnë licencë të tregtisë me energji elektrike dhe licencë të furnizimit me energji elektrike, respektivisht licencë të tregtisë me gaz natyror dhe licencë të furnizimit me gaz natyror, dërgojnë të dhëna vetëm në formularët e llojit nga paragrafi (3) të destinuar për furnizuesit, në të cilët i përfshijnë të dhënat që dalin nga aktivitetet e tyre nga tregtia.
- (12) Të gjitha të dhënat e dërguara nga bartësit e licencave, në përputhje me këtë rregullore, do të konsiderohen si konfidenciale dhe KRRE-ja do t'i përdorë dhe do t'i ruajë në mënyrën e përcaktuar me akt në përputhje me rregullat e mbrojtjes së të dhënave.
- (13) Për shkak të sigurimit të Përcjelljes efikase të funksionimit të tregjeve të energjisë, KRRE-ja mund të mbledhë, të përdorë dhe të analizojë të dhëna dhe informata nga burimet e tjera, të cilat do t'i përdorë dhe do t'i publikojë në përputhje me ligjin, rregull tjetër dhe standardet e pranuar ndërkombëtare.

Neni 5

Raportet e Përcjelljes së funksionimit të tregjeve të energjisë

- (1) Në bazë të të dhënave dhe informatave të mbledhura dhe të analizuara në përputhje me këtë rregullore, KRRE-ja në përputhje me Ligjin e Energjetikës, sëpaku një herë në vit përgatit dhe publikon raporte të monitorimit dhe të funksionimit të tregjeve të energjisë.
- (2) Në raportet nga paragrafi (1), KRRE-ja do të publikojë vetëm informata mbledhëse për indikatorët e veçantë. Nëse për një indikator të caktuar, informatat mbledhëse janë marrë nga më pak se tre bartës të licencave të kryerjes së veprimtarive të parregulluara energjetike, këto informata mbledhëse nuk do të publikohen në raporte.

Neni 6

Besueshmëria e të dhënave të dërguara

- 1) Bartësit e licencave duhet, që për secilën licencë që iu është lëshuar, të autorizojnë personin, i cili do të jetë i detyruar të dërgojë të dhëna dhe informata nga kjo rregullore dhe të komunikojë me KRRE-në përmes postës elektronike dhe/ose wev platformës.
- 2) Autorizimi nga paragrafi (1) dërgohet në formular, që përmban edhe deklaratën e besueshmërisë së të dhënave. Formulari nga ky paragraf publikohet në faqen e internetit të KRRE-së.
- 3) Formularin nga paragrafi (2), bartësit e licencave të kryerjes së veprimtarive energjetike, e dërgojnë deri te KRRE-ja në formë elektronike më së voni shtatë ditë nga dita e hyrjes në fuqi të licencës së kryerjes së veprimtarisë energjetike.
- 4) Bartësit e licencave duhet t'a njoftojnë KRRE-në për ndryshimin eventual të personit të autorizuar nga paragrafi (1) përmes dërgimit të formularit të ri nga paragrafi (2) në afat prej shtatë ditëve nga ndryshimi i bërë.
- 5) Të gjitha të dhënat e dërguara nga personi i autorizuar nga paragrafi (1) do të llogariten si të sakta dhe të besueshme, respektivisht se korrespondojnë plotësisht me gjendjen faktike.
- 6) Bartësit e licencave të kryerjes së veprimtarive energjetike mund të dërgojnë korrigjim të të dhënave të dërguara, më së voni 30 ditë nga dita e dërgimit të të dhënave, që janë lëndë e korrigjimit, në mënyrë të përcaktuar në udhëzimet nga neni 4 paragrafi (3).

II Tregu i energjisë elektrike Neni

7

Qëllimet e Përcjelljes së funksionimit të tregut të energjisë elektrike

- (1) Përcjellja e gjendjes së tregut të energjisë elektrike kryhet veçmas për:

- 1) strukturën (përfshirë edhe ristrukturimin) e tregut të energjisë elektrike të përcaktuar me ligj dhe
- 2) efikasitetin e funksionimit të tregut të energjisë elektrike
- (2) Përcjellja e strukturës së tregut të energjisë elektrike nga paragrafi (1) kryhet nga aspekti i:
 - 1) liberalizimit të tregut të energjisë elektrike; dhe
 - 2) arritja e shkallës së caktuar ligjore të pavarësisë funksionale, financiare dhe ligjore në kryerjen e veprimtarisë së rregulluar energjetike të OSTEE-së dhe OSSH-së në raport me veprimtaritë e prodhimit, të tregtisë dhe të furnizimit.
- (3) Përcjellja e efikasitetit të tregut të energjisë elektrike nga paragrafi (1) kryhet me Përcjelljen dhe analizën e sjelljes dhe aktivitetëve të pjesëmarrësve në:
 - 1) funksionimin e tregut me shumicë;
 - 2) funksionimin e tregut me pakicë;
 - 3) kyçja, qasja dhe përdorimi i rrjeteve të transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike; dhe
 - 4) cilësia e shërbimeve për konsumatorët.
- (4) Përcjellja e funksionimit të tregut me shumicë kryhet përmes përcjelljes së prodhimit të energjisë elektrike, importit dhe transmetimit të energjisë elektrike dhe çmimeve në tregun me shumicë.
- (5) Përcjellja e funksionimit të tregut me pakicë kryhet përmes përcjelljes së çmimeve në tregun me pakicë dhe zbatimi i procedurës së ndërrimit të furnizuesit.
- (6) Përcjellja e cilësisë së shërbimeve përbëhet nga përcjellja e: vazhdimësisë në furnizimin me energji elektrike, cilësisë së tensionit dhe cilësisë së shërbimeve komerciale dhe atyre të rrjetit.

Neni 8

Funksionaliteti i tregut të energjisë elektrike

- (1) Bartësit e licencave të tregtisë me energji dhe/ose furnizim me energji, si dhe të transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike dërgojnë të dhëna dhe informata për: numrin e furnizuesve sipas grupeve përkatëse të konsumatorëve dhe sasive të dërguara sipas grupeve përkatëse të konsumatorëve.
- (2) OTEE-ja dhe OSSH-ja janë të detyruar të dërgojnë të dhëna dhe informata të nevojshme për Përcjelljen e procedurës së ndërrimit të furnizuesit, përfshirë edhe të dhënat dhe informatat për numrin e kërkesave të parashtruara, konsumi i energjisë në të kaluarën i përdoruesve që kërkojnë ndërrimin e furnizuesit, ndryshimet e kryera sipas grupeve të konsumatorëve dhe respektim të afateve të caktuara për kohëzgjatjen e procedurës.
- (3) Gjatë dërgimit të të dhënave për numrin e kërkesave të parashtruara, ndryshimet e kryera dhe kohëzgjatja e procedurës, periudha e njoftimit për OTEE është dymbëdhjetë muaj.
- (4) Bartësit e licencave të furnizimit me energji elektrike dërgojnë të dhëna për disponueshmërinë dhe përmbajtjen e pakove komerciale, të cilat ua ofrojnë klientëve të tyre.

Neni 9

Pavarësia funksionale, financiare dhe ligjore e transmetimit dhe e shpërndarjes së energjisë elektrike

- (1) OSTEE-ja dhe OSSH-ja janë të detyruar, që më së voni deri më 28 shkurt në secilin vit të dërgojnë informata për vitin e mëparshëm kalendarik, për zbatimin e programeve për harmonizim, me të cilat do të sigurohet pavarësia e tyre e plotë ligjore, financiare, administrative dhe funksionale e punës së kompanive energjetike të integruara vertikalisht, të cilave u përkasin apo me të cilat janë të lidhura, gjatë:
 - 1) kryerjes së veprimtarisë transmetim në lidhje me veprimtaritë prodhim, shpërndarje, tregti dhe furnizim,
 - 2) kryerjes së veprimtarisë shpërndarje në lidhje me veprimtaritë prodhim, transmetim, furnizim dhe furnizim në rastin e fundit me energji elektrike, në rastet kur shërbehen më shumë se 100.000 konsumatorë të kyçur, si dhe

- 3) sigurim i shërbimeve publike në mënyrën me të cilën sigurohet mosdiskriminim, transparencë dhe paanshmëri në funksionimin e tregut të energjisë elektrike.

Neni 10

Prodhimi i energjisë elektrike

- (1) Bartësit e licencave të prodhimit të energjisë elektrike janë të detyruar të dërgojnë të dhëna dhe informata të nevojshme për përcjelljen e prodhimit të energjisë elektrike, përfshirë edhe të dhënat për:
- 1) fuqinë e instaluar dhe energjinë elektrike të prodhuar nga secili central elektrik, përfshirë edhe konsumin personal,
 - 2) të dhënat për konsumin dhe shpenzimet e energjisë primare,
 - 3) çmimet mesatare të shitjes dhe sasi të energjisë elektrike të shitur sipas grupeve të blerësve;
 - 4) jodisponueshmëria e planifikuar dhe e paplanifikuar e njësive prodhuese dhe
 - 5) të dhënat nga kërkesat për pagesën e premive për prodhuesit preferencial, që përdorin premi.
- (2) OTEE është i detyruar të dërgojë të dhëna dhe informata të nevojshme për Përcjelljen e prodhimit nga prodhuesit e energjisë elektrike, të cilëve iu është miratuar përdorimi i tarifës preferenciale, përfshirë edhe të dhënat për:
- 1) llojin, numrin e vetëm të regjistrimit, emrin e prodhuesit, sasi të energjisë elektrike dhe pagesat për secilin prodhues preferencial dhe
 - 2) sasi të totale të energjisë elektrike të prodhuar dhe pjesëmarrjen e energjisë elektrike totale të prodhuar nga prodhuesit preferencial në konsumin e përgjithshëm.
- (3) OSSH-të janë të detyruar të dërgojnë të dhëna për energjinë elektrike të dorëzuar dhe të marrë në dhe nga sistemi i shpërndarjes nga konsumatorët-prodhuesit e energjisë elektrike.

Neni 11

Importi, transmetimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike

- (1) OSTEE-ja është i detyruar të dërgojë të dhëna për përcjelljen e funksionimit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike:
- 1) bilancin e energjisë elektrike për sistemin e transmetimit të energjisë elektrike;
 - 2) disponueshmërinë e kapaciteteve transmetuese përtejkuftare dhe zbatimin e procedurave për ndarjen e tyre; dhe
 - 3) të dhëna për kapacitetet e ndara përtejkuftare të transmetimit, të ardhurat totale dhe çmimet mesatare për secili kufi.
 - 4) të dhënat për sasi dhe shpenzimet për shërbimet sistimore;
- (2) OSTEE-ja është e detyruar të dërgojë të dhëna dhe informata për debalancet e realizuara në intervalet kohore dhe sipas grupeve të balancit.
- (3) OSSH-të janë të detyruar të dërgojnë të dhëna dhe informata për balancin e energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes.
- (4) OTEE-ja është e detyruar të dërgojë të dhëna në lidhje me aspektet komerciale të funksionimit të tregut me shumicë me energji elektrike.

Neni 12

Çmimet e energjisë elektrike dhe tarifat e transmetimit dhe të shpërndarjes

- (1) Bartësit e licencave të tregtisë dhe të furnizimit me energji elektrike duhet të dërgojnë të dhëna dhe informata për:
- 1) çmimet mesatare të prokurimit dhe sasi të energjisë elektrike;
 - 2) çmimet mesatare të shitjes dhe sasi të energjisë elektrike sipas grupeve të konsumatorëve.
 - 3) Bartësit e licencave të transmetimit ose të shpërndarjes së energjisë elektrike duhet të dërgojnë të dhëna dhe informata për:
 - 4) tarifat dhe të ardhurat nga transmetimit, respektivisht nga shpërndarja e energjisë elektrike dhe

- 5) çmimet mesatare të energjisë elektrike të prokuruar për mbulimin e humbjeve.
- (2) OTOEE është i detyruar të dërgojë të dhëna dhe informata që janë të nevojshme për përcjelljen e gjendjeve në tregun e organizuar të energjisë elektrike për transaksionet dhe ankandet implicite të kapaciteteve, të dhënat për ofertat dhe kërkesa e tregut të organizuar (sasitë dhe çmimet) dhe të dhënat e tjera që dalin nga bashkimi i tregut me tregjet e tjera të energjisë elektrike.

Kyçja, qasja dhe përdorimi i rrjeteve të transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike

Neni 13

Kyçja në rrjet

- Ø OSTEE-ja dhe OSSH-ja janë të detyruar të dërgojnë të dhëna dhe informata të nevojshme për përcjelljen e kyçjes në rrjete, përfshirë edhe të dhënat dhe informatat për:
- 1) numrin e kërkesave të parashtruara, të miratuara dhe të realizuara të kyçjes së konsumatorëve sipas grupeve të konsumatorëve, sipas kategorive të kyçjeve dhe sipas nivelit të tensionit, si dhe për prodhuesit e energjisë elektrike;
 - 2) kompensimet e kyçjes dhe
 - 3) numrin e përdoruesve të shkyçur dhe arsyet e shkyçjes.
- Ø Gjatë dërgimit të të dhënave për numrin e kyçjeve sipas nivelit të tensionit dhe për numrin e konsumatorëve të shkyçur, periudha e njoftimit për OTEE-në është dymbëdhjetë muaj.

Neni 14

Qasja deri në rrjet

- (1) OSTEE-ja dhe OSSH-ja janë të detyruar të dërgojnë të dhëna dhe informata të nevojshme për përcjelljen e parimit të qasjes së rregulluar të palës së tretë, përfshirë edhe të dhënat për numrin e kërkesave të parashtruara, të miratuara dhe të refuzuara për qasje në rrjetin me të cilin udhëheqin.

Cilësia e

shërbimeve Neni 15

Vazhdimësia e furnizimit

- Ø OSTEE-ja dhe OSSH-ja janë të detyruar të dërgojnë të dhëna dhe informata të nevojshme për përcjelljen e vazhdimësisë në furnizim me energji elektrike, përfshirë edhe të dhënat dhe informatat për:
- 1) numrin e ndërprerjeve të planifikuara/ paplanifikuara sipas nivelit të tensionit;
 - 2) kohëzgjatjen e ndërprerjeve të paplanifikuara sipas nivelit të tensionit dhe
 - 3) indikatorët e përcjelljes së vazhdimësisë së furnizimit me energji elektrike (SAIDI, SAIFI) të sistemeve të shpërndarjes.

Neni 16

Cilësia e shërbimeve të rrjetit dhe e atyre komerciale

- 1 Bartësit e licencave të shpërndarjes dhe të furnizimit me energji elektrike duhet të dërgojnë të dhëna dhe informata për:
- 1) numrin dhe llojin e kundërshtimeve të marra, të miratuara dhe të refuzuara, si dhe kohën mesatare për përgjigje;
 - 2) numrin dhe llojin e kërkesave të parashtruara për informata nga konsumatorët; dhe
 - 3) komunikimin e realizuar me përdoruesit në llojin e numrit të përgjithshëm të paraqitjeve telefonike, porosive elektronike të dërguara nga dhe drejt konsumatorëve, vizitat e qendrave të përdoruesve dhe kërkesat e dërguara me shkrim sipas grupeve të konsumatorëve.
- Ø OSSH-të janë të detyruar të dërgojnë të dhëna dhe informata të nevojshme për përcjelljen e cilësisë së tensionit, përfshirë edhe të dhënat dhe informatat për: numrin, llojin dhe kohën mesatare të përgjigjes ndaj kundërshtimeve të parashtruara, të cilat i referohen problemeve në lidhje me cilësinë e tensionit.

- ⌘ Bartësit e licencave të transmetimit, të shpërndarjes dhe të furnizimit me energji elektrike, me kërkesë të KRRE-së, janë të detyruar të dërgojnë të dhëna për:
- 1) disponueshmërinë publike të informatave për përdoruesit e sistemit të transmetimit dhe të sistemeve të shpërndarjes në lidhje me kyçjen dhe qasjen deri te rrjeti dhe
 - 2) disponueshmërinë publike të informatave për konsumatorët në lidhje me marrëveshjet standarde me furnizuesit, ndryshimin e kushteve për lidhjen e marrëveshjes, mundësitë e pagesës, çmimet, procedura e ndryshimit të furnizuesit dhe ekzistimi i qendrës së kontaktit për përdoruesit.

III Tregu i gazit

natyror Neni 17

Qëllimet e përcjelljes së funksionimit të tregut të gazit natyror

- (1) Përcjellja e funksionimit të tregut të gazit natyror ndahet në këto fusha:
 - 1) strukturim dhe ristrukturim i tregut të gazit natyror; dhe
 - 2) funksionim efikas i tregut të gazit natyror.
- (2) Struktura e tregut të gazit natyror ndiqet nga aspekti i:
 - 1) gjendjes së tregut të gazit natyror; dhe
 - 2) arritja e shkallës së caktuar ligjore të pavarësisë funksionale, financiare dhe ligjore në kryerjen e veprimtarisë së rregulluar energjetike të OST-ja dhe OSSH-ja.
- (3) Përcjellja e efikasitetit të tregut të gazit natyror kryhet me përcjelljen dhe analizën e sjelljes dhe aktivitetëve të pjesëmarrëve në:
 - 1) funksionimin e tregut me shumicë;
 - 2) funksionimin e tregut me pakicë;
 - 3) kyçjen, qasjen dhe përdorimin e rrjeteve të transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror; dhe
 - 4) cilësinë e shërbimeve për konsumatorët.
- (4) Përcjellja e funksionimit të tregut të gazit natyror me shumicë kryhet përmes mbledhjes së të dhënave dhe të informatave për:
 - 1) importin dhe transmetimin e gazit natyror dhe
 - 2) çmimet e gazit natyror në tregun me shumicë.
- (5) Përcjellja e funksionimit të tregut të gazit natyror me pakicë kryhet përmes mbledhjes dhe analizës së të dhënave dhe të informatave për:
 - 1) çmimet e gazit natyror në tregun me pakicë; dhe
 - 2) zbatimin e procedurës për ndërrimin e furnizuesit.
- (6) Përcjellja e cilësisë së shërbimeve në tregun e gazit natyror përbëhet prej mbledhjes dhe analizës së të dhënave dhe përgatitjen e raporteve për cilësinë e shërbimeve të përdoruesve të siguruara nga OST dhe OSSH dhe furnizuesit, posaçërisht për:
 - 1) cilësinë e shërbimeve të rrjetit dhe të atyre komerciale; dhe
 - 2) vazhdimësinë në furnizim me gaz natyror.

Neni 18

Funksionaliteti i tregut të gazit natyror

- ⌘ Bartësit e licencave të transmetimit të gazit natyror, organizimit dhe menaxhimit me tregun e gazit natyror, shpërndarjes, furnizimit dhe tregtisë me gaz natyror, janë të detyruar të dërgojnë të dhëna dhe informata për numrin e konsumatorëve të furnizuar sipas grupeve përkatëse të konsumatorëve (sipas grupeve të prodhuesve të energjisë termike dhe/ose elektrike, konsumatorët e tjerë dhe amvisëritë, ndërsa aty ku është e zbatueshme edhe për furnizuesit/ tregtarët, shpërndarja dhe konsumi personal si he sipas grupeve të konsumatorëve industrial dhe amvisërive) dhe për sasi të shitura sipas grupeve përkatëse të konsumatorëve.
- ⌘ OST dhe OSSH janë të detyruar të dërgojnë të dhëna dhe informata të nevojshme për përcjelljen e procedurës së ndërrimit të furnizuesit, përfshirë edhe të dhënat dhe informatat për numrin e kërkesave të parashtruara, konsumi i energjisë në të kaluarën i përdoruesve që kërkojnë ndërrimin e furnizuesit,

ndryshimet e kryera sipas grupeve të konsumatorëve dhe respektim të afateve të caktuara për kohëzgjatjen e procedurës.

Ø Gjatë dërgimit të të dhënave për numrin e kërkesave të parashtruara, ndryshimet e kryera dhe kohëzgjatjen e procedurës, periudha e njoftimit për OST është dymbëdhjetë muaj.

Ø Bartësit e licencave të furnizimit me gaz natyror dërgojnë të dhëna për disponueshmërinë dhe përmbajtjen e pakove komerciale, të cilat ua ofrojnë klientëve të tyre.

Neni 19

Pavarësia funksionale, financiare dhe ligjore e operatorëve të transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror

Ø OST-ja dhe OSSH-ja janë të detyruar, që më së voni deri më 28 shkurt në secilin vit të dërgojnë informata për vitin e mëparshëm kalendarik, për zbatimin e programeve për harmonizim, me të cilat do të sigurohet pavarësia e tyre e plotë ligjore, financiare, administrative dhe funksionale e punës së kompanive energjetike të integruara vertikalisht, të cilave u përkasin apo me të cilat janë të lidhura, gjatë:

- 1) kryerjes së veprimtarive transmetim të gazit natyror në lidhje me veprimtaritë tregti dhe furnizim;
- 2) kryerjen e veprimtarisë shpërndarje e gazit natyror në lidhje me veprimtaritë tregti dhe furnizim me gaz natyror në raste kur shërbehen më shumë se 100.000 konsumatorë, si dhe
- 3) sigurimin e shërbimeve publike në mënyrën, me të cilën sigurohet mosdiskriminim, transparencë dhe paanshmëri në funksionimin e tregut të gazit natyror.

Neni 20

Importi, transmetimi dhe shpërndarja e gazit natyror

Ø OST-ja është e detyruar të dërgojë të dhëna dhe informata për importin dhe transmetimin e gazit natyror përmes sistemit të transmetimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, disponueshmërinë e kapaciteteve të gazpërçuesve dhe zbatimin e procedurës së ndarjes së kapaciteteve, përfshirë edhe informatat dhe të dhënat për:

- 1) bilancin e gazit natyror për sistemin e transmetimit;
- 2) disponueshmërinë e kapaciteteve të gazpërçuesve interkonektues; dhe
- 3) zbatimin e procedurave të ndarjes së kapaciteteve, kapaciteteve të ndara dhe gazpërçuesve interkonektues dhe çmimet e tyre mesatare.
- 4) tarifat e transmetimit të gazit natyror.

Ø OTGN-ja është i detyruar të dërgojë të dhëna në lidhje me organizimin e tregut të gazit natyror, posaçërisht të dhëna për:

- 1) pjesmarrësit në tregun e gazit natyror me shumicë,
- 2) debalancet e realizuara në intervale kohore dhe sipas grupeve të balancit; dhe
- 3) kompensimet për debalance.

Ø OSSH-ja duhet të dërgojnë të dhëna dhe informata për bilancin e gazit natyror në suaza të sistemeve të shpërndarjes, me të cilët udhëheqin.

Neni 21

Çmimet e gazit natyror dhe tarifat e transmetimit dhe të shpërndarjes

Ø Bartësit e licencave të transmetimit të gazit natyror, të organizimit dhe menaxhimit me tregun e gazit natyror, të shpërndarjes, të tregtisë dhe të furnizimit me gaz natyror, duhet të dërgojnë të dhëna dhe informata të nevojshme për përcjelljen e ndryshimeve në çmimet e gazit natyror, përfshirë edhe informatat dhe të dhënat për:

- 1) çmimet mesatare dhe sasi të gazit natyror, të cilin e përdorin prodhuesit e energjisë elektrike dhe/ose energjisë termike;
- 2) çmimet mesatare të prokurimit dhe sasi të gazit natyror;
- 3) çmimet mesatare të shitjes dhe sasi të gazit natyror sipas grupeve të konsumatorëve;

- 4) çmimet mesatare dhe sasi të gazit natyror të prokuruar për shërbimet sistemore dhe për konsum personal;
- 5) tarifatat dhe të ardhurat nga transmetimi dhe shpërndarja e gazit natyror.

Lidhja, qasja dhe përdorimi i rrjeteve të transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror

Neni 22

Kyçja në rrjet

- (1) OST dhe OSSH janë të detyruar të dërgojnë të dhëna dhe informata të nevojshme për përcjelljen e kyçjes në rrjete, përfshirë edhe të dhënat dhe informatat për:
 - 1) numrin e kërkesave të parashtruara, të miratuara dhe të realizuara për kyçje sipas grupeve të konsumatorëve;
 - 2) kompensimet e kyçjes dhe
 - 3) numrin e përdoruesve të shkyçur.

Neni 23

Qasje deri në rrjet

- (1) OST-ja është i detyruar të dërgojë të dhëna dhe informata të nevojshme për përcjelljen e sigurisë së mundësisë për qasje deri te rrjeti, në bazë të parimit të qasjes së rregulluar të palës së tretë, posaçërisht për numrin e kërkesave të parashtruara dhe të miratuara për qasje dhe kohën mesatare për miratimin e kërkesave.

Cilësia e

shërbimeve Neni 24

Vazhdimësia në furnizim

- (1) OST-ja dhe OSSH-të janë të detyruar të dërgojnë të dhëna dhe informata të nevojshme për përcjelljen e vazhdimësisë së furnizimit me gaz natyror, posaçërisht për:
 - 1) numrin e ndërprerjeve të planifikuara/ paplanifikuara sipas grupeve përkatëse të konsumatorëve; dhe
 - 2) kohëzgjatjen e ndërprerjeve të planifikuara dhe të paplanifikuara.

Neni 25

Cilësia e shërbimeve të rrjetit dhe e atyre komerciale

- ¶ Bartësit e licencave të furnizimit, transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror janë të detyruar të dërgojnë të dhëna dhe informata të nevojshme për përcjelljen e cilësisë së shërbimeve komerciale dhe atyre të rrjetit, posaçërisht:
 - 1) numrin dhe llojin e kundërshtimeve të marra, të miratuara dhe të refuzuara, si dhe kohën mesatare për përgjigje; dhe
 - 2) numrin dhe llojin e kërkesave të parashtruara për informata nga konsumatorët.
 - 3) komunikimin e realizuar me përdoruesit në llojin e numrit të përgjithshëm të paraqitjeve telefonike, porosive elektronike të dërguara nga dhe drejt konsumatorëve, vizitat e qendrave të përdoruesve dhe kërkesat e dërguara me shkrim sipas grupeve të konsumatorëve.
- ¶ OST-ja dhe OSSH-të që menaxhojnë sistemet e shpërndarjes, që nuk janë të lidhura me sistemin e transmetimit dhe janë të detyruara të dërgojnë të dhëna për strukturën dhe vlerën energjetike të gazit natyror të importuar, respektivisht të prokuruar.
- ¶ Bartësit e licencës së tregtisë, të furnizimit, të transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror, me kërkesë të KRRE-së, janë të detyruar të dërgojnë të dhëna për:
 - 1) disponueshmërinë publike të informatave për konsumatorët në lidhje me marrëveshjet standarde me furnizuesit dhe ndryshimet në kushtet për marrëveshjet, çmimet, kushtet e pagesës dhe procedurën e ndryshimit të furnizuesit; dhe
 - 2) disponueshmërinë publike të informatave për përdoruesit e sistemit të transmetimit dhe të sistemeve të shpërndarjes në lidhje me kyçjen dhe qasjen deri te rrjeti.

IV Tregtia me naftë të papërpunuar, me derivate të naftës dhe me karburante për transport Neni 26

Qëllimet e përcjelljes së tregut

- (1) Përcjellja e tregut të naftës së papërpunuar, të derivateve të naftës dhe të lëndëve djegëse për transport përbëhet nga përcjellja, analizimi dhe përgatitja e raporteve për kushtet që kanë lidhje me:
- 1) importin, eksportin dhe transportin e naftës së papërpunuar, të derivateve të naftës dhe të lëndëve djegëse për transport;
 - 2) përpunimin e naftës së papërpunuar, prodhimin e derivateve të naftës dhe prodhimin e lëndëve djegëse të destinuara për transport me përzierje të derivateve të naftës dhe të biogarubrave; dhe
 - 3) funksionimin e tregjeve të naftës së papërpunuar, të derivateve të naftës, të biokarburanteve dhe të karburanteve për transport.

Neni 27

Importi, eksporti dhe transporti

- ¶ Bartësit e licencave të transportit me naftë të papërpunuar përmes naftëpërçuesit, transporti i derivateve të naftës përmes produktpërçuesit, tregtia me shumicë me naftë të papërpunuar, me derivate të naftës, me karburante për transport dhe me biokarburante, janë të detyruar të dërgojnë të dhëna dhe informata për:
- 1) sasi të importuara dhe të tregtuara të naftës së papërpunuar, karburanteve për përzierje dhe biokarburanteve dhe çmimet mesatare;
 - 2) naftën e papërpunuar, derivatet e naftës dhe karburantet për transport të transmetuara përmes naftëpërçuesit, respektivisht përmes produktpërçuesit.

Neni 28

Përpunimi i naftës së papërpunuar dhe prodhimi i derivateve të naftës dhe i karburanteve për transport

- (1) Bartësit e licencave për përpunimin e naftës së papërpunuar dhe prodhimin e derivateve të naftës dhe prodhimin e karburanteve të destinuara për transport me përzierje të derivateve të naftës dhe të biokarburanteve, janë të detyruar të dërgojnë të dhëna dhe informata për sasi të prodhuara sipas llojit, sasi të shitura sipas llojit dhe për çmimet mesatare të shitjes së derivateve të naftës sipas llojit.

Neni 29

Funksionimi i tregut me naftë të papërpunuar, me derivate të naftës dhe me karburante për transport

- (1) Bartësit e licencave të tregtisë me shumicë me naftë të papërpunuar, me derivate të naftës, me biokarburante dhe me karburante për transport janë të detyruar të dërgojnë të dhëna dhe informata të nevojshme për përcjelljen e tregut me naftë të papërpunuar, me derivate të naftës dhe me karburante për transport, përfshirë edhe të dhënat dhe informatat e sasive të prokuruar dhe të shitura dhe çmimet mesatare të prokurimit dhe të shitjes së naftës së papërpunuar, të derivateve të naftës, të biokarburanteve dhe të karburanteve për transport sipas llojit, si dhe vendi i origjinës së naftës së papërpunuar, të derivateve të naftës, të biokarburanteve dhe të karburanteve për transport që janë importuar, sipas llojit.

V Tregu i energjisë termike Neni

30

Qëllimet e përcjelljes së tregut

- ¶ Përcjellja e tregut të energjisë termike përbëhet nga përcjellja, analizimi dhe njoftimi për kushtet që kanë lidhje me:
- 1) prodhimin e rregulluar të energjisë termike;
 - 2) prodhimin e energjisë termike;

- 3) shpërndarjen e energjisë termike;
- 4) furnizimin me energji termike;
- 5) procedurën e ndërrimit të furnizuesit;
- 6) shpenzimet për prodhimin e energjisë termike sipas llojit të impjanteve; dhe
- 7) cilësinë e shërbimit.

Neni 31

Prodhimi i energjisë termike

- 0) Bartësit e licencave të prodhimit të rregulluar të energjisë termike dhe të prodhimit të energjisë termike, janë të detyruar të dërgojnë të dhëna dhe informata të nevojshme për përcjelljen e prodhimit të energjisë termike në periudhën nga tetori deri në prill, përfshirë edhe të dhënat për:
- 1) fuqinë e instaluar, prodhimin e energjisë termike nga secila njësi prodhuese, përfshirë edhe konsumin personal;
 - 2) sasi të mesatare dhe shpenzimet për karburantet, të cilat përdoren për prodhimin e energjisë termike;
 - 3) sasi të mesatare dhe çmimet e energjisë termike të shitur;
 - 4) jodisponueshmëri e paplanifikuar e njërive prodhuese të prodhuesve; dhe
 - 5) temperatura mesatare e ajrit për rajonin, në të cilin prodhuesit e rregulluar dorëzojnë energji termike.

Neni 32

Shpërndarja e energjisë termike

- 1) Bartësit e licencave të shpërndarjes së energjisë termike, janë të detyruar të dërgojnë të dhëna dhe informata të nevojshme për përcjelljen e shpërndarjes së energjisë termike në periudhën nga tetori deri në prill, përfshirë edhe të dhënat për:
- 1) bilancin e energjisë termike,
 - 2) tarifën dhe të ardhurat nga shpërndarja e energjisë termike dhe
 - 3) ndërrimi i furnizuesve, përfshirë edhe numrin e ndërrimeve të realizuara të furnizuesve.

Neni 33

Furnizimi me energji termike

- 1) Bartësit e licencave të furnizimit me energji termike, janë të detyruar të dërgojnë të dhëna dhe informata në lidhje me furnizimin me energji termike, përfshirë edhe të dhënat dhe informatat për:
- 1) sasi të mesatare dhe çmimet e prokurimit të energjisë termike;
 - 2) numrin e vendeve matëse aktive dhe të shkyçura të konsumatorët sipas llojit të vendit matës (vende matëse me konsumatorë nga lloji i amvisërive, arsimit, konsumatorët e tjerë dhe vendet matëse të kombinuara me konsumatorë nga më shumë lloje);
 - 3) fuqia e angazhuar dhe e instaluar dhe sipërfaqja e ngrohjes sipas llojit të konsumatorit (amvisëritë, arsimit dhe konsumatorët e tjerë) për konsumatorët aktivë dhe pasivë;
 - 4) të dhënat në lidhje me numrin e leximeve të pajisjeve të matjes në ndarjen lokale të konsumit të energjisë termike dhe
 - 5) kompensimin e fuqisë së angazhuar dhe të energjisë.

Neni 34

Ndërrimi i furnizuesit

- (1) Bartësit e licencave të furnizimit me energji termike, janë të detyruar të dërgojnë të dhëna dhe informata të nevojshme për përcjelljen e ndërrimit të furnizuesit, përfshirë edhe numrin e ndërrimeve të realizuara të furnizuesve.

Neni 35

Vazhdimësia e furnizimit

- (1) Bartësit e licencave të furnizimit me energji termike janë të detyruar të dërgojnë të dhëna dhe informata të nevojshme për përcjelljen e vazhdimësisë së furnizimit me energji termike në periudhën nga tetori deri në prill, përfshirë edhe të dhënat për numrin e ndërprerjeve të planifikuara dhe të paplanifikuara në furnizim, si dhe kohëzgjatjen e ndërprerjeve të paplanifikuara.

Neni 36

Cilësia e shërbimeve të rrjetit dhe e atyre komerciale

- (1) Bartësit e licencave të furnizimit me energji termike, janë të detyruar të dërgojnë të dhëna dhe informata të nevojshme për përcjelljen e cilësisë së shërbimeve komerciale, përfshirë edhe të dhënat dhe informatat për:
 - 6) numrin e kërkesave të parashtruara, të miratuara dhe të realizuara për konsumatorët e rinj, për shkyçje, për rikyçje dhe për ndryshimin e kapacitetit sipas llojit të konsumatorit dhe kohën mesatare të realizimit të kërkesave;
 - 7) numrin dhe llojin e kundërshtimeve të marra, të miratuara dhe të refuzuara, si dhe kohën mesatare për përgjigje ndaj kundërshtimeve të parashtruara nga konsumatorët
 - 8) numrin e kërkesave të parashtruara për informata.
- (2) Bartësit e licencave të furnizimit me energji termike, me kërkesë të KRRE-së janë të detyruar të dërgojnë të dhëna për disponueshmërinë publike të informatave për konsumatorët në lidhje me marrëveshjet standarde me furnizuesit, çmimet dhe procedurën e ndërrimit të furnizuesit.

VI Dispozitat

kalimtare Neni

37

- (1) Detyrimi për dërgimin e raporteve, të dhënave dhe të informatave në përputhje me këtë rregullore, fillon me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, ndërsa do t'i referohet të dhënave të bartësve të licencave nga data 1 qershor 2019.
- (2) Bartësit e licencave, të cilët e kanë plotësuar detyrimin dhe kanë dërguar formularin nga neni 6, paragrafi (1) i Rregullores së Përcjelljes së Funksionimit të Tregjeve të Energjisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 83/15 dhe 215/16), do të llogaritet se e kanë përbushur detyrimin nga neni 6 paragrafi (1) i kësaj rregullore.

VII Dispozitat

përfundimtare

Neni 38

- (1) Me ditën e hyrjes në fuqi të kësaj rregullore, nuk vlen më Rregullorja e Përcjelljes së Funksionimit të Tregjeve të Energjisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 83/15 dhe 215/16).
- (2) Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e publikimit të saj në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

ARSYETIM

Në bazë të nenit 25 paragrafi (3) i Ligjit të Energjetikës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 96/18), Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit i Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni Rregullator i Energjetikës) iu qas përpunimit të Rregullores së Mënyrës dhe të Procedurës së Përcjelljes së Funkzionimit të Tregjeve të Energjisë.

Komisioni Rregullator i Energjetikës e përpunoi Rregulloren e Mënyrës dhe të Procedurës së Përcjelljes së Funkzionimit të Tregjeve të Energjisë në suaza të Marrëveshjes së Shërbimeve Konsultative nga Fusha e Elektroenergjetikës, Politikës Energjetike dhe Rregullores në Energjetikë mes Komisionit Rregullator të Energjetikës dhe Fakultetit të Elektroteknikës dhe të Teknologjive Informatike.

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra dhe procedurat e përcjelljes së funksionimit të tregjeve të energjisë përmes përcjelljes së aktiviteteve të operatorëve të sistemeve të transmetimit dhe të shpërndarjes, që kanë lidhje me funksionimin e tregjeve të energjisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe aktiviteteve të të gjithë bartësve të tjerë të licencave që marrin pjesë në tregje.

Në datën 20 maj 2019, Komisioni Rregullator i Energjetikës, në faqen e tij të internetit e publikoi Propozim-Rregulloren e Mënyrës dhe të Procedurës së Përcjelljes së Funkzionimit të Tregjeve të Energjisë.

Komisioni Rregullator i Energjetikës, me aktvendim nr. 02-1158/1 datë 20 maj 2019, thirri seancë përgatitore, në të cilën lëndë e shqyrtimit ishte Propozim-Rregullorja e Mënyrës dhe e Procedurës së Përcjelljes së Funkzionimit të Tregjeve të Energjisë. Në seancën përgatitore ishin të ftuar: anëtarët e Komisionit Rregullator të Energjetikës, përfaqësuesit nga SHA MEPSO, ELEKTRODISTRIBUCIJA SHPKNJP Shkup, SHA ELEM Shkup, EVN HOME SHPK Shkup, EVN MAQEDONI SHA Shkup, EVN MAQEDONI Elektrosnabduvanje SHPKNJP Shkup, SHA CEMV Shkup, përfaqësuesit e bartësve të licencave të kryerjes së veprimtarive energjetike, Kabineti i Zëvendëskryetarit të Qeverisë së RMV-së përgjegjës për çështje ekonomike, Ministria e Ekonomisë, Oda Ekonomike e Maqedonisë, Oda Ekonomike e Maqedonisë veri-perëndimore, Lidhja e Odave Ekonomike të Maqedonisë, Këshilli i Mbrojtjes së Konsumatorëve, Organizata e Konsumatorëve të Maqedonisë dhe përfaqësuesi i Komisionit të Mbrojtjes së Konkurrencës.

Më 6 qershor 2019 u mbajt seanca përgatitore, në të cilën morrën pjesë anëtarët e Komisionit Rregullator të Energjetikës, përfaqësuesit nga Ndërmarrja e Gyppërçuesve të Naftës Selanik- Shkup - VARDAKS SHA - filiali VARDAKS Shkup, Shoqëria e Tregtisë MAKPETROL PROM-GAS SHPKNJP Shkup, Komisioni i Mbrojtjes së Konkurrencës, MAKPETROL SHA Shkup, MAKSTIL SHA Shkup, SHA MEPSO Shkup, GA-MA SHA Shkup, FEIT, EDS SHPKNJP Shkup, U POVER SHPK Shkup, TE-TO SHA Shkup, Furnizimi me Ngrohje BE; EVN MAQEDONI SHA Shkup, EVN MAQEDONI Elektrosnabduvanje SHPKNJP Shkup, SHA TCE Negotinë, ALPIK ENERGIJA, SHA CEMV (ESM) Shkup.

Në seancën përgatitore nga të pranishmit u dhanë komente sa i përket Propozim-Rregullores së Mënyrës dhe të Procedurës së Përcjelljes së Funkzionimit të Tregjeve të Energjisë.

Duke pasur parasysh vërejtjet e dërguara në afatin e dhënë, vërejtjet e dhëna në seancën përgatitore nga palët e interesuara, Komisioni Rregullator i Energjetikës përpunoi tekstin e Rregullores së Mënyrës dhe të Procedurës së Përcjelljes së Funkzionimit të Tregjeve të Energjisë, si propozim për miratim.

Komisioni Rregullator i Energjetikës, në seancën e mbajtur më 4 korrik 2019, mbajti seancë, në të cilën miratoi Rregulloren e Mënyrës dhe të Procedurës së Përcjelljes së Funkzionimit të Tregjeve të Energjisë.